

Ky fletë udhëzim shërben si informacion për viktimat sipas nenit. 305 paragrafi 1 në kodin e procedurës penale të Zvicrës (StPO). **Në mënyrë që të drejtat tuaja të merren në konsideratë ose për pyetjet eventuale të sqarohen, ju mund t'i drejtoheni personit përgjegjës të policisë ose të prokurorisë, ose në njërën prej qendrave të këshillimit që janë të renditura në fund.**

Kush është viktimë sipas kodit të procedurës penale (StPO) dhe ligjit mbi ndihmën e viktimës (OHG)

Si viktimë konsiderohet personi i dëmtuar cili përmes një veprimi penal është i dëmtuar drejtpërdrejtë në integritetin e tij trupor, seksual ose psikik.

Në qoftë se të afërmit e viktimës parashtrojnë kërkesa civile, atëherë edhe atyre ju takojnë të drejtat njësoj si dhe viktimës. Si të afërm të viktimës konsiderohen bashkëshortja e tij ose bashkëshorti i saj, fëmijët dhe prindërit e tij si dhe persona të cilët në mënyrë të ngjashme janë të afërmit e tij.

Të drejtat e viktimës në procedurën penale (neni 117 në vijim, StPO)

• E drejta për informim

Viktima dhe të afërmit e viktimave do të orientohen plotësisht nga policia dhe prokuroria mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre në procedurën penale, gjatë marrjes në pyetje herën e parë (neni 305 paragrafi 1 StPO). Përveç kësaj ju merrni informatat për:

- a. adresat dhe detyrat e qendrave këshilluese për viktimat;
- b. shërbimet financiare sipas ligjit mbi ndihmën e viktimës dhe
- c. afati për dorëzimin e kërkesave për kompensim dëmi dhe dëmshpërblim.

Të gjitha informatat e duhura janë të përfshira në këtë fletë udhëzim!

Viktima do të orientohet mbi urdhëresën dhe pezullimin e burgimit të sigurisë ose hetuesisë si dhe arratisjen e të pandehurit, nëse përveç kësaj ajo shprehimisht nuk ka hequr dorë nga një gjë e tillë (neni 214 paragrafi 4 StPO).

Aktakuza më shkrim do ti përcillet menjëherë edhe viktimës nga prokuroria (neni 327 paragrafi 1 StPO).

Viktimat dhe të Afërmit e Viktimave mund të kërkojnë përmes një Shkresë, që të informohen nga ana e autoritetve juridike për gjerat vijuese:

- Për kohën e fillimit të zbatimit të denimit apo masës së denimit të të denuarit, për vendin e të burgut, për formën e zbatimit të denimit, për nderpremtjen e denimit, për hapjen e zbatimit të ndeshkimit dhe për lirimin e kushtezuar ose perfundimin si dhe rikthimi në burg apo masën e denimit.
- menjehere lidhur me një arratisje të denuarit dhe perfundimin e saj.

(Art.92a të Librit Federal Ligjorë lidhur për të drejtën e viktimes për informata)

• E drejta mbi mbrojtjen e personalitetit

Autoritet zyrtarë të ndëshkimit i ruajnë të drejtat e personalitetit të viktimës në të gjitha etapat e procesit gjyqësor (neni 152 paragrafi 1 StPO), veçanërisht:

- Gjatë seancës gjyqësore, për të mbrojtur personalitetin e viktimës, gjykata mundet tërësisht ose pjesërisht të largoj publikun nga procesi gjyqësor (neni 70 paragrafi 1 lit. a StPO).
- Jashtë një seance gjyqësore autoritetet zyrtare dhe ato private, ju lejohet të bëjnë publike identitetin e një viktime ose të japin informata të cilat lejojnë identifikimin e saj, vetëm në kushte të jashtëzakonshme dhe nën kushte të caktuara (neni 74 paragrafi 4 StPO).

- **E drejta e shoqërimit nga një person i besueshëm**

Viktima ka të drejtë që në të gjitha procedurat gjyqësore, përveç ndihmës juridike, të shoqërohet nga një person i besueshëm i tij (neni 152 paragrafi 2 StPO).

Në qoftë së publiku është i përjashtuar nga seanca gjyqësore, atëherë viktima mund të shoqërohet prej më së shumti tre personave të tij të besueshëm (neni 70 paragrafi 2 StPO).

- **E drejta për masat e mbrojtjes**

Autoritet zyrtare penale mundësishtë e shmangin takimin e viktimës me personin e akuzuar, në qoftë se viktima e kërkon këtë (neni 152 paragrafi 3 StPO).

Të drejtat shitesë të viktimës nga veprimet penale kundër integritetit seksual

Viktima e një veprimi penal kundër integritetit seksual mundë të:

- kërkoj, që të merret në pyetje nga një person i gjinisë seksuale të njëjtë (neni 153 paragrafi 1 StPO);
- kërkoj, që për përkthimin e marrjes në pyetje të sjellin një person të gjinisë së njëjtë (neni 68 paragrafi 4 StPO; *nëse dëshiron këtë, ju lutem të na lajmëroni sa më parë që të jetë e mundur në mënyrë që të mundemi me kohë të organizojmë përkthyesen ose përkthyesin*);
- të refuzoj deklaratën e pyetjeve, të cilat prekin në sferën intime të saj (neni 169 paragrafi 4 StPO).

Një ballafaqim me të pandehurin mund të urdhërohet kundër vullnetit të viktimës, vetëm në qoftë se kërkesa e të pandehurit për tu dëgjuar në mënyrë të ligjshme, nuk mund të garantohet në një formë tjetër (neni 153 paragrafi 2 StPO).

Gjykatës, e cila ka për të vlerësuar veprimin penal kundër integritetit seksual, me kërkesën e viktimës, duhet që së paku një person ti përkasë gjinisë së njëjtë si viktima (neni 335 paragrafi 4 StPO).

Masat e veçanta për mbrojtjen e viktimave të mitura (neni 154 StPO)

Këto masa vlejné për viktimat, të cilat në momentin e marrjes në pyetje ose të ballafaqimit janë të mitur.

Policia dhe prokuroria mund t'a përjashtojë personin e besueshëm, në qoftë së ky person mund t'i krijojë një ndikim të caktuar viktimës së mitur.

Në qoftë së marrja në pyetje ose ballafaqimi për viktimën e mitur mund t'a shpinte në ngarkesa të rënda psikike, atëherë vlen si në vijim:

- Viktima e mitur ka të drejtë të ballafaqohet më të pandehurin, në qoftë së ky shprehimisht e kërkon një gjë të tillë (neni 154 paragrafi 4 lit. a StPO).
- Viktima e mitur ka të drejtë sipas rregullit, gjatë gjithë procedurës gjyqësore, të merret në pyetje jo më shumë se dy herë (neni 154 paragrafi 4 lit. b StPO).
- Marrjet në pyetje zhvillohen në praninë e një specialistje ose një specialisti, nga një nëpunëse zyrtare e hetuesisë ose një nëpunës zyrtarë i hetuesisë që është e/i kualifikuar në këte drejtim dhe këto të regjistrohen me video dhe me zë (neni 154 paragrafi 4 lit. d StPO).

Paditë private

- **Kërkesa për tu dëgjuar në mënyrë të ligjshme (neni 107 StPO)**

Pas hapjes së procesit hetimor nga ana e prokurorisë, viktima e cila shprehimisht ka sqaruar se në procesin gjyqësor do të marrë pjesë si paditëse penale ose paditëse civile ose paditës civil, ka të drejtë për tu ndëgjuar në mënyrë të ligjshme. Kjo nënkupton veçanërisht të drejtën për:

- a. të parë dosjet;
- b. të marrë pjesë në procedurat penale;
- c. të marrë mbështetje juridike;
- d. të shprehet rreth çështjes dhe procedurës gjyqësore;
- e. të parashtrij kërkesat e dëshmive.

- **Njoftimet mbi padinë civile (neni 122 në vijim, StPO)**

Personi i dëmtuar mundet si paditës privat që në procedurën penale të parashtroj kërkesat e të drejtës civile të veprës penale.

Edhe të afërmeve të viktimës ju takon e drejta e njëjtë, përdërisa këto kërkesa kundrejt të pandehurit parashtrohen si kërkesa civile të tyre.

Padia civile përkundrejt policisë apo prokurorisë duhet të parashtrohet me sqarimet e duhura. Kërkesa e parashtruar në padinë civile duhet të jetë e sqaruar me pika dhe shkurtimisht e argumentuar me shkrim.

Nëse padia private e tërheq akuzën private para përfundimit të instancës së parë të gjyqimit kryesor, këtë mund të parashtrohet përsëri në gjykatën civile.

Detyrat e qendrave për këshillim të ndihmës së viktimave (adresat dhe ofertat shih faqen e fundit)

Qendrat për këshillim japin informata dhe këshilla, viktimave mbi të drejtat e tyre, ose ndërmjetësojnë sipas nevojës në ndihmë mjekësore, psikologjike, sociale, materiale dhe juridike. Shërbimet e qendrave për këshillim janë falas.

Në qoftë së viktima është e pajtimit, policia menjëherë përcjell emrin dhe adresën e viktimës në njërin prej qendrave për këshillim (neni 305 paragrafi 3 StPO). Pas marrjes së njoftimit qendra për këshillim menjëherë do të vihet në lidhje me viktimën.

Format e ndihmës së viktimës (neni 2 të ligjit mbi ndihmën e viktimës, OHG)

Ndihma për viktimën përfshin:

- a. këshillim dhe ndihmë të menjëhershme;
- b. ndihmë afatgjatë prej qendrave për këshillim;
- c. kontributet për ndihmë afatgjatë të personit të tretë;
- d. kompensim;
- e. dëmshpërblim;
- f. lirim nga shpenzimet e gjyqit.

Sipas nenit 2 OHG do ti jepet ndihmë viktimës, në qoftë së kundërvajtja është kryer në Zvicër. Në qoftë së kundërvajtja është kryer jashtë shtetit, atëherë mund të shfrytëzohen shërbimet e qendrave për këshillim; nuk do ti jepen zhdëmtime dhe dëmshpërblime.

Kompensimi (neni 19 në vijim, OHG)

Viktima dhe të afërmit e tij kanë të drejtë kompensimi për dëmin e pësuar (financiarë) si rrjedhim i dëmtimit ose vdekjes së viktimës.

Shërbimet, të cilat viktima i ka marrë si zhdëmtim do ti zbriten nga kompensimi. Shuma e kompensimit arrin më së larti 120'000 franga zvicerane; asnjë kompensim nuk do të paguhet në qoftë së kjo shumë është më pak se 500 franga.

Autoritetet kompetente kantonale japin një paradhënie nëse:

- a. personit me të drejtë ligjore pretendimi i nevojitet ndihmë e menjëhershme financiare dhe
- b. pasojat e veprimit penal nuk mund të verifikohen me siguri të mjaftueshme në afat të shkurtër.

Dëmshpërblimi (neni 22 në vijim, OHG)

Viktima dhe të afërmit e tij kanë të drejtë dëmshpërblimi (shpagim për dhimbje), në qoftë se justifikohet masa e peshës së dëmtimit.

Dëmshpërblimi matet me masën e peshës së dëmtimit. Ajo është më së shumti:

- a. 70'000 franga për viktimën;
- b. 35'000 franga për të afërmit

Një dëmshpërblim do të jepet, në qoftë së viktima është e tronditur rëndë dhe se rrethanat e veçanta e arsyetojnë një gjë të tillë. Faji i autorit të krimit nuk ka kriterë vendimtare.

Parashtrimi i kërkesës dhe afatet (neni 24 në vijim, OHG)

Ai i cili dëshiron të parashtrij kërkesën për kompensim apo dëmshpërblim ose të marrë një paradhënie të kompensimit, duhet të bëjë një lutje pranë autoriteteve përkatëse të kantonit.

Viktima dhe të afërmit e saj duhet të dorëzojë kërkesën për kompensim dhe dëmshpërblim **brenda pesë vitesh pas veprës penale ose pas marrjes në dijeni të veprës penale**; përndryshe humb e drejta mbi kërkesat.

Shërbimet e ndihmës për viktimën kompensohen dhe behën, vetëm në qoftë se autorët e krimit ose një person tjetër përgjegjës për këtë ose sigurimi, shërbimet nuk i bëjnë fare ose i bëjnë vetëm pjesërisht.

Qendrat për këshillim të kantonit të Thurgau

- **Fachstelle Opferhilfe Thurgau, Stiftung BENEFO, Zürcherstrasse 149, 8500 Frauenfeld
Tel. 052 723 48 26, opferhilfe@benefo.ch**
Qendrat për këshillim janë për të gjitha rastet në përgjithësi, të cilat nuk i takojnë kategorisë së viktimave, për të cilat ekzistojnë në një ofertë speciale.
- **Ofrimi i dorës për ndihmë, tel. 143**
Këshilla anonime përmes telefonit në situata kritike **është 24-h në funksionim për të gjitha format e dhunës.**